



REPUBLIKA E SHQIPERISE
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURISË
Nr. 177 Prot.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E DOGANAVE
Nr. 5732 Prot.

AKT- MARREVESHJE

Lidhur sot më datë 1.7.2004, ndermjet :

Inspektoratit te Larte te Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive, përfaqësuar nga Inspektori i Përgjithshëm, znj. Fatmira Laska, në bazë të tagrit që i jep Ligji nr.9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", që më poshtë do të quhet **ILDKP.**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, z. Shpëtim Idrizi, në bazë të tagrit që i jep ligji nr.8449, datë 27.1.1999 "Për Kodin Doganor në Republikën e Shqipërisë", me adresë Rruga e Elbasanit, që më poshtë do të quhet **DPD.**

Palët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, lidhin marrëveshjen, si më poshtë;

Neni 1

Objekti i Akt-marrëveshjes

Objekti i kësaj akt-marrëveshje është përcaktimi i procedurave për realizimin e komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit lidhur me procesin e deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe detyrimeve financiare.

Neni 2

Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj akt-marrëveshje është ligji nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i procedurave administrative", ligji nr.9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve

dhe të disa nëpunësve publikë”, ligji nr. 8449, datë 27.1.1999 “Për Kodin Doganor ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë çështje që parashikohen në dispozitat e kësaj akt-marrëveshje.

Neni 3

Qëllimi i Akt-marrëveshjes

Qëllimi i kësaj akt-marrëveshje është realizimi i shkëmbimit të informacionit, që lidhet me procesin e deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe detyrimeve financiare.

Neni 4

Detyrime te Inspektoratit te Larte te Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive

Për të kryer kontrollin dhe verifikimin e të dhënave të deklaratës, informacioni i nevojshëm do t'i vihet në dispozicion ILDKP-së, pas kërkesës me shkrim të Inspektorit të Përgjithshëm.

Për të pasur efikasitet në bashkërendimin e punës ndërmjet palëve, kërkesa duhet të jetë e përcaktuar me të dhënat e domosdoshme në mënyrë që informacioni i kërkuar të identifikohet pa vështirësi.

Neni 5

Detyrimet e Drejtorise së Përgjithshme të Doganave

DPD-ja, angazhohet të verë në dispozicion çdo informacion apo të dhënë që disponon ajo, në lidhje me kërkesën e detajuar nga ILDKP-ja, i cili ka të bëjë me vetëdeklarimin e subjektit për të cilin kërkohet ky informacion.

DPD-ja, pas protokollimit të kërkesës, brënda 15 ditëve do të verë në dispozicion të personit të autorizuar nga ILDKP-ja, të dhënat e kërkuara.

DPD-ja, do të autorizojë personin e kontaktit, i cili do të përgjigjet drejtpërdrejt për kërkesen e bërë nga ILDKP-ja.

Neni 6 **Zbatimi i Akt-marrëveshjes**

Çdo ndryshim i akteve ligjore e nënligjore, për aq sa ato lidhen me këtë akt-marrëveshje, do të reflektohet zyrtarisht në ndryshimin e saj.

Korrespondenca midis paleve do të bëhet brenda ditës me korier të posaçëm.

Të dy institucionet angazhohen të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e kësaj akt-marrëveshje. Zbatimi i saj është i detyrueshëm për palët.

Neni 7 **Hyrja në fuqi**

Akt-marrëveshja hartohet në dy kopje, të cilat kanë fuqi ligjore të njëjta dhe shpërndahet si më poshtë:

- Një kopje për ILDKP-në,
- Një kopje për DPD-në.

Kjo akt-marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga palët.

**PER INSPEKTORATIN E
LARTE TE DEKLARIMIT DHE
KONTROLLIT TE PASURIVE**

Inspektori i Përgjithshëm

FATMIRA LASKA



**PER DREJTORINE
E PERGJITHSHME TE
DOGANAVE**

Drejtori i Përgjithshëm

SHPËTIM IDRIZI

A handwritten signature in black ink, appearing to read "SHPËTIM IDRIZI".